



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.145/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Nenad Llazić dhe Afijete Sada-Gillogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkritazi me ankesën e Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të fëmijëve në fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahën me datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur me 02.10.2019, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** e pabazuar ankesa Anr.145/2019 e datës 30.09.2019, e paraqitur nga Rrjeti Balkanik Hulumtues për Gazetari (BIRN) dhe Inter News Kosova, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë.

### A r s y e t i m

Organizata BIRN me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 27.09.2019, me të cilën pretendon se me datën 28 shtator 2019 rreth orës 18:30 në tubimin zgjedhor të PDK-së në Ferizaj janë parë fëmijë duke mbajtur materiale promovuese të fushatës, ku këto fotografi janë shfaqur në transmetimin e drejtpërdrejt të fushatës, ku shihet një fëmijë nën moshën 15 vjeçare duke mbajtur një flamur të PDK-se. Paraqitësi i ankesës pretendon se përdorimi i fëmijëve në fushatë është i ndaluar me rregulloren e re 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d). Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi lidhur me rastin në fjalë. Me propozim për panelin që ankesa të pranohet si e bazuar.

Në përgjigje në ankesë të datës 01.10.2019, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), thekson se ankesa e BIRN dhe IKS është e pa baze, për arsye se pretendimet e tyre për shkelje të rregullores 20/2019 për fushatën e zgjedhjeve dhe njoftimit për ngjarjet, gjegjësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d) nuk qëndron nga se fotografia e ofruar si dëshmi është e pa qartë. Andaj, subjekti politik PDK i propozon PZAP-së që ankesa e BIRN dhe IKS të hudhet si e pabazuar.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se: **Ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, vendimet e tij i bazon në dëshmi qarta dhe bindëse siç është përcaktuar me nenin 117 paragrafi 3 i LZP-së, e që në rastin konkret fotografia e ofruar nga ankuesi se një fëmijë nën moshën 15 vjet, është duke e mbajtur një flamur në dorë të subjektit politik

PDK, për panelin është e paqartë dhe nuk është bindëse për te vendosur ndryshe në këtë rast, ngase prej fotografisë që gjendet në shkresat e lëndës nuk mund të identifikohet se fëmija është duke e promovuar subjektin politik PDK, në fushatë siç pretendohet nga ankuesi. Andaj, pretendimet ankimore të ankuesit së është bërë shkelja e Rregullës Zgjedhore 20/2019, për fushatën e zgjedhjeve, përkatësisht nenin 5 paragrafi 3 pika d), nga ana e subjektit politik PDK, janë të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore, për faktin se, veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të rregullës zgjedhore 02/2019, për ndryshimin dhe plotësimin e rregullës zgjedhore Nr. 13/2013.

Nga arsyet e theksuar me lart e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, neni 117 paragrafi 3 neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me nenin 8 paragrafi 4 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.145/2019 më datën 02.10.2019

**Kryesuesi i Panelit**  
Adnan Konushevi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.